



DEKLARIM

I PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË (Ligji Nr. 9049, Datë 10.04.2003)

- **Kush mbart detyrimin për deklarim:**
Të gjithë subjektet (personat) që mbajnë funksionet e renditura në nenin 3 të ligjit.
- **Llojet e deklarimit, afati i plotësimit të deklaratës dhe objekti i deklarimit:**
Sipas llojit të deklarimit vendosni në kuti shenjen 'X'.
- Deklarimi i pare apo para fillimit të punës** në një nga funksionet që të detyron të deklarosh pasurinë duhet plotësuar brenda 30 ditëve të fillimit të detyrës.
Në këtë lloj deklarimi duhet të pasqyrohen për deri më 31 Dhjetor të vitit paraardhës të gjitha pasuritë e akumuluar ndë vite, detyrimet financiare, burimet dhe origjina e pasurise të vetë subjektit, bashkëshortit/es dhe të fëmijëve ne moshe madhore me të cilët figuron në një përbërje familjare. (Lexo nenin 6 , 9 dhe 21 të ligjit).
- Deklarimi vjetor** dorëzohet brenda dates 31 Mars të çdo viti. Ne kete lloj deklarimi duhet te pasqyrohen vetëm ndryshimet ne gjendjen e pasurive për periudhën nga 1 Janari deri më 31 Dhjetor të vitit paraardhës, burimet e krijimit të tyre, si dhe detyrimet financiare të vetë subjektit, bashkëshortit/es dhe të fëmijëve ne moshe madhore me të cilët figuron në një përbërje familjare. (Lexo nenin 4 të ligjit).
- Deklarimi pas largimit nga funksioni** duhet plotësuar deri 2 vjet (2 deklarime vjetore) pas largimit nga funksioni dhe deri në 4 vjet (4 deklarime vjetore) për disa lloj funksionesh. (Lexo nenin 8 të ligjit). Llogaritja e ketij deklarimi eshte 31 Dhjetori i vitit paraardhes.
- Deklarimi me kërkesë** bëhet me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm ndaj personave juridikë e fizikë të lidhur me subjektin që mbart detyrimin për deklarim te pasurise. (Lexo nenin 7 të ligjit).
- **Pyetje, ndihmë dhe ku do të merret e dorëzohet deklarata:**
Të gjithë subjektet janë të detyruar te marrin e te dorezojne dokumentin deklarate pranë Inspektoratit të Ulët të ngritur në Institucionet ku kryejnë funksionin apo ku kanë punuar deri pas largimit nga funksioni, sipas rastit mund edhe të kërkohet ndihmë për plotësimin e saj po në Inspektoratin e Ulët. (Lexo nenin 18, 19, 23 të ligjit).
Në qoftë se ju keni pyetje të tjera kontaktoni me ILDKP në numrin pa pagesë **0800 9999**, si dhe ne numrin **234 918**.
Për me tepër informacion mund të drejtoheni në: **www.hidaa.gov.al**
- **Masat administrative:** Refuzimi për deklarim sjell humbjen e funksionit, publikimin, ndëshkimin në përputhje me Kodin Penal. (Lexo nenin 5 te ligjit).
Kur deklarata dhe dokumentet shoqëruese nuk paraqiten në afatin e caktuar, pa shkaqe të arsyeshme, subjekti gjobitet me 25000 lekë. Në qoftë se deklarata nuk dorëzohet edhe 15 ditë pas komunikimit të gjobës njoftohen organet përkatëse dhe gjoba dyfishohet. (Lexo nenin 40 te ligjit).
Vërtetoj se deklaramet e bëra në vijim nga unë janë të plota, të vërteta, të sakta dhe mbaj përgjegjësi ligjore për vertetesine e tyre.

TE DHËNAT PERSONALE

Plotëso me gërma të mëdha

Emri	Atesia	Mbiemri
ARBEN	MENTOR	ELEZI
Funksioni	Institucioni	
PERGJEGJES I POLICISE TATI MORE	DEGATATIM TAKSAVE ELBASAN	
Adresa e Institucionit	Vendi	
GODINATATIM TAKSAVE TEK ISH QENDRA LLOGARITESE	ELBASAN	
Data e emrimit në detyrë	Data e largimit nga detyra	Data e dorëzimit të deklaratës
13.01.2006		23.04.2006

Sipas nenit 34 të ligjit te dhënat e deklaratës publikohen, përveç të dhënave të faqes 7 dhe 8.

Nënshkrimi

ARBEN ELEZI



PASURITË E PALUAJTSHME DHE TË LUAJTSHME

Në këtë seksion do të pasqyroni pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, (në emër të deklaruesit, bashkëshortit/es dhe fëmijëve madhorë) të ndodhura brenda ose jashtë Shqipërisë deri më date 31 Dhjetor të vitit paraardhës.

Çfarë përfshihet në pasuritë e paluajtshme:

Toka, burime, rrjedhje uji, uzina, fabrika, dyqane, shtëpi e apartamente banimi, ndërtime të ndryshme si hoteleri, pike karburanti, magazina, pishina etj. mbi të cilat ju ushtroni një të drejtë reale, pavarësisht nëse janë të regjistruara ose jo në Z.R.P. të Paluajtshme. (Në kolonën përkatëse do të përshkruani me hollësi pronën, si p.sh. sasinë në natyrë, sip. në m², vlerën e pronës, vitin e ndërtimit etj).

Çfarë përfshihet në pasuritë e luajtshme:

Të gjitha mjetet motorike për të cilat është i detyrueshëm regjistrimi në një organ shtetëror siç janë; zyrat noteriale, tatimore, drejtoritë e shfrytëzimit të automjeteve, kapiteneria e porteve, të regjistrit hekurudhor, ajror, gjykata, banka etj, pasuritë e tjera të luajtshme si sende që kanë një vlerë të veçantë mbi 5000 dollar amerikanë (ose ekuivalenti në cdo monedhe tjetër), aksione, letra me vlerë, gjendje cash, pjesë kapitali në zotërim, likuiditete në bankë, duke përfshirë këtu edhe depozitat për fëmijët e mitur apo personat që keni në ngarkim etj. (Lexo nenin 4 të ligjit).

Kujtesë: Në deklarinë vjetor do të pasqyroni vetëm ndryshimet e ndodhura në pasurinë tuaj gjatë një viti.

Të dhënat për pasuritë që do të deklaroni si p.sh. numrat e regjistrave të Z.R.P.P., numra të ndryshëm të regjistrave publikë, emra të personave të cilëve u keni dhënë hua në lekë apo në valutë të huaj etj. që ju e çmoni se janë konfidenciale, do t'i shënoni në faqen 7, e cila nuk do të publikohet.

Përshkrimi i hollësishëm i çdo lloj pasurie. (Lexo nenin 21 të ligjit)	Vlera e secilës pasuri në lekë apo në valutë, në momentin e krijimit	Pjesa që zotëron (në % sasi apo vlerë)	Data, viti i krijimit të pasurisë
1 SHTËPI BANIMI DHOMË + GËZHINË	DHOMË + GËZHINË 500.000		VJETËR
2			
3			
4			
5			

Deklarimi është i pavlefshëm nëse nuk pasqyroni identitetin e firmën.
Nëse kjo tabelë është e pamjaftueshme mund të vazhdoni në faqen 4.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

ARIBEN ELEZI



PASURITË E PALUAJTSHME DHE TË LUAJTSHME

Përshkrimi i hollësishëm i çdo lloj pasurie. (Lexo nenin 21 te ligjit)	Vlera e secilës pasuri në lekë apo në valutë, në momentin e krijimit.	Pjesa që zotëron (në % sasi apo vlerë)	Data, viti i krijimit të pasurisë
6			
7			
8			
9			
10			
11			
12			

Deklarimi është i pavlefshëm nëse nuk pasqyroni identitetin e firmën.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
ARBEN ELEZI



DETYRIMET FINANCIARE NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË

Deklarimi i detyrimeve financiare si kërkesë e nenit 4 të ligjit do ndihmojë në argumentimin e drejtë të pasurisë së vënë ndër vite apo gjatë një viti.

Çfarë detyrimesh do të përfshihen:

Në tabelën e mëposhtme duhet të renditen të gjitha detyrimet financiare (kredi, hua, borxh etj.) që keni patur ose keni ju, bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhorë (që keni në përbërjen familjare) dhe që ju kanë shërbyer për të krijuar pasuri të ndryshme të paluajtshme apo të luajtshme.

Detyrimet do të shprehen në lekë apo në valutë sikurse është bërë akt-marrëveshja, të tregohet shkaku i marrjes, shuma e marrë, kohëzgjatja dhe personi huadhënës sipas tabelës së mëposhtme.

Plotësoni dy kolonat e fundit në lekë apo në valutë (me shifra dhe me shkrim)

Përshkrimi i hollësishëm i detyrimit financiar. (shuma e marrë, kohëzgjatja, interesi bazë, etj)	Numri dhe data e kontratës (nëse ka)	Ndaj kujt keni detyrime financiare	Shuma e detyrimit financiar (+ interesa) e shlyer deri më 31 Dhjetor	Shuma e detyrimit financiar (+ interesa) e pashlyer, deri më 31 Dhjetor
1				
2				
3				
4				
5				

Deklarimi është i pavlefshëm nëse nuk pasqyroni identitetin e firmën.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

ARBEN ELEZI



TË ARDHURAT

Çfarë përfshihen në të ardhurat:

Të ardhurat vjetore nga paga, shpërblime, pjesëmarrja në borde, komisione apo çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura, shitja apo qiraja e përfutur nga objekte të ndryshme të luajtshme apo të paluajtshme, të ardhurat që përfitohen nga liçensat dhe patentat, të ardhurat individuale që përfitohen nga qënia ortak apo pjesëmarrës në kapital në shoqëritë fitimprurëse (shuma e dividendit apo fitimit të tërhequr nga biznesi ku subjekti është pjesëmarrës) ose të ardhurat nga çdo lloj përfshirje në organizatat jofitimprurëse, përqindjet e përfutura nga depozitat bankare apo nga huadhëniet e realizuara me personat juridikë e fizikë, si dhe çdo lloj e ardhure tjetër.

Kujtesë:

Në deklarin e pare apo para fillimit të detyrës subjekti duhet të deklarojë edhe të ardhurat e realizuara në përgjithësi ndër vite; personale, të bashkëshortit/es dhe fëmijëve që ka në përbërjen familjare.

Në deklarin vjetor subjekti duhet të deklarojë të gjitha të ardhurat e siguruara deri më 31 Dhjetor të vitit paraardhës, si ato personale, të bashkëshortit/es dhe fëmijëve që ka në përbërje familjare.

Përshkrimi më vete i çdo lloj të ardhure për secilin pjesëtar të familjes së subjektit dhe mënyra e sigurimit të këtyre të ardhurave.	Shuma faktike e të ardhurave vjetore që kanë qenë në disponim të personit e familjes në lekë apo në valutë. (e ardhura neto, me shifra dhe me shkrim)	Vendi i punës, emërtimi i aktivitetit nga i cili janë siguruar të ardhurat, adresat përkatëse.
1		
2		
3		
4		
5		
6		
7		

Deklarimi është i pavlefshëm nëse nuk pasqyroni identitetin e firmën.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

ARBEN ELEZI



AUTORIZIM
PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË PASURISË

Në zbatim të nenit 10 të ligjit Nr.9049, data 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", Unë

ARBEN ELEZI

si subjekt i detyrimit për deklarim të pasurisë nën përgjegjësinë time, autorizoj Inspektoratin e Lartë/ të Ulët ose çdo person tjetër të autorizuar nga Inspektori i Përgjithshëm, të ushtrojë çdo lloj kontrolli mbi vërtetësinë, saktësinë dhe burimet e pasurive personale dhe familjare, që ndodhen brenda dhe jashtë Shqipërisë, në të gjitha subjektet, publike dhe private.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

ARBENELEZI

Dorëzuar më date

23.01-2006

Adresa e kontaktit

Për çdo ndryshim të mundshëm, njoftoni pranë Inspektoratit të Lartë/ Ulët.

Email

Telefon Zyre

Celular Zyre

Fax Zyre

Kujtesë:

Deklarata dhe të gjitha dokumentet që e shoqërojnë atë janë dokumente zyrtare.

Ekzistojnë sanksione ligjore administrative dhe penale në rast të fshehjes ose të deklarimit të rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë. (Lexo nenin 5, 28, 31, 32 dhe 38 të ligjit Nr.9049, date 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", si dhe nenin 257/a të Kodit Penal).